



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Zhvillimit Rajonal*  
*Ministarstvo za Regionalni Razvoj*  
*Ministry of Regional Development*

---

## **UDHËZUESI PËR APLIKANTËT E GRANTEVE PËR VEPRIMTARITË ZEJTARE**

### **Skema e Granteve**

**“Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar për veprimtaritë e bizneseve mikro Zejtare/Manufakturë, Artizanale, Inovative etj. 2024”**

- **Biznes ekzistues;**

**Autoriteti Kontraktues:**  
**Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR)**

**Afati për dorëzimin e aplikacionit:**  
Nga 15.05.2024 deri më 06.12.2024

## Përmbajtja:

1. Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar për veprimtaritë e bizneseve mikro Zejtare/Manufakturë, Artizanale, Inovative 2024“.....	3
1.1 Hyrje .....	3
1.2 Skema: veprimtaritë Zejtare /Manufakturë, Artizanale, inovative.....	3
1.3 Përkrahja financiare e ofruar nga Ministria e Zhvillimit Rajonal.....	4
2 Mënyra e aplikimit / kush dhe si mund të aplikoj?.....	4
2.1 Shumat minimale dhe maksimale që mund të kërkohen: .....	5
2.2 Kohëzgjatja e projektit .....	5
2.3 Lokacioni i projektit .....	5
2.4 Procedurat e Prokurimit.....	5
3 Rajonet Zhvillimore përfshijnë Komunat në vijim.....	5
4 Informata të mëtutjeshme për aplikimin dhe vlerësimin e Projekt Propozimeve .....	6
4.1 Afati i fundit për aplikim .....	6
5 KRITERET E VLERËSIMIT .....	6
6 Ankesat.....	6

# 1. Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar për veprimtaritë e bizneseve mikro Zejtare/Manifakturë, Artizanale, Inovative 2024“

## 1.1 Hyrje

Ministria e Zhvillimit Rajonal, bazuar në mandatin ligjor që ka, këtë vit për her të parë zhvillon, menaxhon dhe implementon programin për zhvillim rajonal të balancuar për veprimtaritë bizneset mikro Zejtare/Manifakturë, Artizanale, Inovative, etj, program ky që synon jo vetëm mbajtjen “gjallë” të veprimtarive zejtare po edhe të rris zhvillimin socio – ekonomik dhe të trashëgimisë kulturore, familjare e Rajonale tek të rinjët, pse jo edhe zgjerimin e kapaciteteve të atyre prodhuese apo shërbyese si dhe gjenerimin e vendeve të punës, përmes përkrahjes së bizneseve ekzistuese zejtare.

MZHR përmes këtij programi në koordinim me partnerë: Qendrat për Zhvillim Rajonal, AZHR-t dhe Universitetet Partnere synon të ndihmojë bizneset dhe veprimtaritë bizneset mikro Zejtare/Manifakturë, Artizanale, inovative etj. të zgjerojnë kapacitetet e tyre prodhuese/shërbyese. Do të bëhen analiza dhe vlerësime për ruajtjen dhe ngritjen e kapaciteteve të qëndrueshmërisë së këtyre bizneseve/veprimtarive, në veçanti do të punohet me këto kategori në funksion të përkrahjes së tyre si biznese që janë në tendencë të mbylljes dhe zhdukjes së tyre.

Në këtë kontekst, Departamenti për Planifikim dhe Koordinim të Zhvillimit Rajonal do të punoj me përkushtim rreth krijimit të mundësive të reja bashkë me donatorë vendor dhe ndërkombëtar për ngritjen e kapaciteteve të projekt propozimeve në bashkëpunim me Qendrat për Zhvillim Rajonal/AZHR-t dhe Universitetet partnere, në raste edhe në bashkëpunim me partnerët: BERZH, UNICEF, CARITAS-in Zviceran, projektet e financuara nga USAID por duke mos u kufizuar tek këta donatorë. Pra kjo thirrje mund të konsiderohet të jetë në partneritet paralel për programet me donatorë.

Ministria e Zhvillimit Rajonal përmes kësaj skeme mbetet e përkushtuar të mbështesë edhe më fuqishëm projektet e qëndrueshme të udhëhequra nga gratë, të moshuarit, të rinjët që kanë trashëguar veprimtaritë bizneset mikro Zejtare/Manifakturë, Artizanale, Inovative, etj. gjithashtu kjo skemë inkurajon aplikime me projekt propozime edhe komunitetet jo shumicë.

Në vijim, janë të përshkruara të gjitha kriteret e aplikimit dhe udhëzimet për aplikantët potencial.

## 1.2 Skema: veprimtaritë Zejtare /Manifakturë, Artizanale, inovative

Ministria e Zhvillimit Rajonal me lansimin e grant skemës për veprimtaritë bizneset mikro Zejtare/Manifakturë, Artizanale, Inovative, etj, u ndihmon atyre që të plotësojnë nevojat elementare / bazike për vazhdimin e të bërit biznes.

Synimi kryesor i skemës së granteve për veprimtaritë bizneset mikro Zejtare/Manifakturë, Artizanale, Inovative, etj, është që të ju lehtësoj dhe të ju mundësojë që projektet e tyre afariste të implementohen dhe zhvillohen me procedura lehtësuese.

Synimi i përgjithshëm i kësaj thirrjeje për propozime është zhvillimi socio-ekonomik rajonal i veprimtaritë bizneset mikro Zejtare/Manifakturë, Artizanale, Inovative, etj,

që po thuaj se janë në limitet ekstreme të ekzistencës së tyre.

Synimet specifike të kësaj thirrjeje për propozime janë:

1. Përkrahja e veprimtarive bizneset mikro Zejtare/Manufakturë, Artizanale e inovative në vazhdimin e zhvillimit të veprimtarisë / bizneseve të tyre ekzistuese.
2. Përkrahja e veprimtarive bizneset mikro Zejtare/Manufakturë, Artizanale e inovative kontribuon në vazhdimin e traditës dhe mbajtjen "gjallë" të këtyre veprimtarive.

### **1.3 Përkrahja financiare e ofruar nga Ministria e Zhvillimit Rajonal**

Shuma e përafërt e kësaj thirrjeje për vitin 2024 është rreth 50,000.00€ (pesëdhjetë mijë euro) por Ministria e Zhvillimit Rajonal rezervon të drejtën që të mos shpërndajë të gjitha mjetet në dispozicion.

Po ashtu, në rast se Qeveria e Republikës së Kosovës ndanë mjete shtesë për MZHR-në në kategorinë grante dhe subvencione, në cilëndo periudhe kohore pas publikimit të thirrjes, atëherë shumat për këtë skemë mund të rriten në varësi të aplikacioneve dhe projekt propozimeve.

Ministria e Zhvillimit Rajonal shumë prej rreth 50,000.00€ (pesëdhjetë mijë euro), do ta ndajë ekskluzivisht për sektorin e veprimtarive bizneset mikro Zejtare/Manufakturë, Artizanale e Inovative.

Rajonet Zhvillimore bazuar në ligjin për Zhvillim Rajonal me Nr. 08/L-190, konkretisht në Nenin 16, ndarja është shtatë (7) rajone zhvillimore, kurse ndarja e mjeteve do të bëhet bazuar në kërkesat e aplikantëve të asistuar nga Qendrat për Zhvillim Rajonal/ AZHR-t, Universitetet partnere apo nga zyrtarët Monitorues të MZHR-së.

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë individët që kanë biznese të regjistruara. Aplikimi mund të bëhet për sektorët dhe veprimtaritë që vlerësohen se hyjnë në sektorin e veprimtarive Zejtare/Manufakturë.

## **2 Mënyra e aplikimit / kush dhe si mund të aplikoj?**

Aplikantët do të identifikohen sipas raporteve të QZHR/AZHR, universiteteve partnere dhe zyrtareve monitorues të MZHR-së të cilët do të ftohen që të plotësojnë formularin e aplikimit duke përdorur formularin e aplikimit të dizajnuar nga autoriteti kontraktues si dhe:

- Formularit për Aplikim (Shtojca A1);
- Deklarata e aplikantit që merret edhe si deklaratë nën betim për vërtetësinë e dokumentacionit (Shtojca A2);
- Plani i veprimit (Shtojca A3);
- Buxheti dhe burimet e financimit (Shtojca B1)
- Dëshminë që jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të jetë ndërmarrje në pronësi 100% private të regjistruar në Kosovë sipas ligjeve të Kosovës<sup>1</sup>;

- Certifikatën e regjistrimit të biznesit me të gjitha fletët/informatat përcjellëse sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës, e cila duhet të jetë e lëshuar nga ARBK sipas numrit unik identifikues.
- Vërtetimi tatimor me validitet në ditën e aplikimit (jo më i vjetër se 90 ditë) me të cilin vërtetohet se aplikuesi nuk ka borxhe aktuale tatimore të pashlyera apo obligime të tjera tatimore, ose është në marrëveshje për shlyerjen e borxhit me ATK (mund të nxjerret online nga uebfaqja e ATK-së);
- Oferta për makinerinë apo pajisjet/shërbimet e planifikuara në projekt për vlerën totale të projektit - oferta duhet të përmbajë të dhëna të sakta të ofertuesit dhe të dhëna të sakta të marrësit të ofertës po ashtu duhet të ketë edhe emërtimin dhe specifikimin teknik të saktë të pajisjes/shërbimit dhe nuk duhet të jetë më e vjetër se 2 (dy) muaj nga data e aplikimit. Ofertat duhet të jenë të nënshkruara dhe të vulosura nga ofertuesi (Ofertat është e preferueshme të jenë në valutën EURO).

**Formulari dhe materialet përcjellëse mund të merret në uebfaqen e MZHR-së.**

**Nëse aplikanti kalon Fazën e parë Administrative/Verifikuese, do të kërkohen edhe dokumentet në vijim:**

- Lista e punëtorëve e lëshuar nga ATK për v.2023, (mund të nxjerret online nga uebfaqja e ATK-së);

**2.1 Shumat minimale dhe maksimale që mund të kërkohen:**

Shumat e makinave/aparaturës së këtyre granteve duhet të jenë brenda limiteve pesëqind Eurove (500.00 €) dhe nuk duhet kalojnë vlerën e dy mijë Euro (2,000.00€).

**2.2 Kohëzgjatja e projektit**

Kohëzgjatja e planifikuar e projektit që financohet nga MZHR nuk mund të tejkalojë 3 muaj prej ditës së nënshkrimit të Kontratës (përveç nëse ndryshe parashihet me kushtet e kontratës).

**2.3 Lokacioni i projektit**

Veprimet duhet të ndërmerren brenda Rajonit Zhvillimor të prezantuar me rastin e aplikimit.

**2.4 Procedurat e Prokurimit**

Procedurat e Prokurimit do të jenë pjesë e kontratës së nënshkruar në mes të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal dhe përfituesit.

### 3 Rajonet Zhvillimore përfshijnë Komunat në vijim

- Për rajonin zhvillimor **(01)** veprimtaritë e bizneseve që veprojnë në komunat (Prishtinë, Podujevë, Obiliq, Fushë Kosovë, Lipjan, Glllogoc, Graçanicë).
- Për rajonin zhvillimor **(02)** veprimtaritë e bizneseve që veprojnë në komunat (Mitrovica e Jugut, Skenderaj, Vushtrri, Zveqan, Laposaviq, Zubin Potok, Mitrovica Veriore).

- Për rajonin zhvillimor **(03)** veprimtaritë e bizneseve që veprojnë në komunat (Pejë, Istog, Klinë, Deçan).
- Për rajonin zhvillimor **(04)** veprimtaritë e bizneseve që veprojnë në komunat (Prizren, Suharekë, Dragash, Mamushë).
- Për rajonin zhvillimor **(05)** veprimtaritë e bizneseve që veprojnë në komunat (Ferizaj, Shtime, Kaçanik, Shtërpçë, Hani i Elezit).
- Për rajonin zhvillimor **(06)** veprimtaritë e bizneseve që veprojnë në komunat (Gjilan, Kamenicë, Viti, Novobërda, Partesh, Ranillukë, Klllokot).
- Për rajonin zhvillimor **(07)** veprimtaritë e bizneseve që veprojnë në komunat (Gjakovë, Rahovec, Malishevë, Junik)

## 4 Informata të mëtutjeshme për aplikimin dhe vlerësimin e Projekt Propozimeve

Departamenti për Planifikim dhe Koordinim të Zhvillimit Rajonal në baza periodike dhe sipas nevojës do të trajtoj kërkesat dhe me raporte të veçanta përmes Sekretarit të MZHR-së do të kërkoj miratimin e tyre nga Ministri i Ministrisë për Zhvillim Rajonal.

Aplikantët potencial për informata dhe mënyrën e aplikimit ndihmë mund të kërkojnë nga Qendrat për Zhvillim Rajonal / AZHR-të, Universitetet partnere të MZHR-së dhe zyrtarët Monitorues të MZHR-së. Megjithatë, mund të dërgohen pyetje shtesë në email-in: [Hashim.Ibishi@rks-gov.net](mailto:Hashim.Ibishi@rks-gov.net) ose në nr. e telefonit 038 200 645 28. Me rastin e parashtrimit të pyetjeve ato duhet të jenë të qarta e të detajuara.

### 4.1 Afati i fundit për aplikim

Afati i fundit për aplikim është 06.12.2024 ora 16:00.

## 5 KRITERET E VLERËSIMIT

Vlerësimi i Projekt Propozimeve bëhet nga Departamenti për Planifikim dhe Koordinim të Zhvillimit Rajonal.

Pjesa / Elementet e notimit	Vlera e përgjithshme/Pikët maksimale
<b>1. Kapaciteti financiar dhe operacional</b>	<b>20</b>
<b>2. Relevanca e veprimit</b>	<b>25</b>
<b>3. Efektshmëria dhe arritshmëria</b>	<b>25</b>
<b>4. Qëndrueshmëria e veprimit</b>	<b>15</b>
<b>5. Buxheti dhe efektshmëria në kosto</b>	<b>15</b>
<b>GJITHSEJ PIKË (MAKSIMUM)</b>	<b>100</b>

## 6 Ankesat

Pas publikimit të rezultateve, aplikantët mund të adresojnë ankesat e tyre në Shkrimoren e MZHR-së.